




Më
Dana

30-08-2018

NË EMËR TË POPULLIT

 GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm,
Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit
[REDACTED], nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë
Themelore në Ferizaj PP.II.nr.2496-6/17 të dt.12.12.2017, për veprën penale vjedhje pylli
nga neni 358 par.1 të të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë
Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor,
me dt.08.02.2018 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.2496-6/17 të
dt.12.12.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur me
dt. [REDACTED] në të njejtin vend, nga i ati [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së
Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORE

Sepse me dt.05.11. rreth ores 10:30, në vendin e quajtur " Qazim Bekteshi ", në
rajonin ekonomiko-pyJOR Nerodime-Jezerc, Komuna Ferizaj, me qëllim vjedhje në
pyellin e pronësisë shoqërore me sharrë motorike, ka prerë katër /4/ trung të, llojit të ahut
, me diametër 14-36 cm, në lartësi prej të bonitetit III, si dhe me vëllim të përgjithshëm
prej 2.11 metër kub,të cilat i ka transportuar me traktor të markës IMT 539, duke i
shkaktuar kështu dëmë DBZHR Njësisë së Pylltarisë në Ferizaj, në vlerë prej 269,37
Euro,-

Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7, 17,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495 të
KPPK-së.

GJYKON

Të akuzuarin [REDACTED], me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë)
Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e
plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, sipas nenit 46, par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 Euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik-Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 269,37 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumë pre 30 Euro prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.2496-6/17 të dt.12.12.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të njaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht, fletëparaqitjen Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik-Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim në Ferizaj nr.127/2017 e dt.15.11.2017 si dhe procesverbali i përpiluar nga komisioni i ekspertëve për vlerësimin e dëmit me numër 806/2017 i dt.15.11.2017, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik-Sektorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 269,37 Euro,- në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmerise së ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të

KPPRK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e viktmave të krimit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.3136/2017 dt.08.02.2018

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.